




Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Gjiçanit  
Opština Gnjilane  
Municipal Gjiçan  
Gilan Belediyesi

Në bazë të nenit 11, nenit 12, paragrafi 12.1 dhe 12.2, nenit 17, pika (b) të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (*Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28/ datë 04 Qershor 2008*); nenin 25 të Ligjit nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës (*GZ e R.Kosovës nr.10/03 Prill 2019*); nenit 29, paragrafi 3, paragrafi 4 dhe paragrafi 1.5 nenit 31 të Rregullores QRK nr.09/2020 Për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës; Nenit 37, pika 1.2 , 1.3 dhe 1.6 të Statutit të Komunës së Gjiçanit (*01.nr.016-126211 të datës 06.11.2014*) me qëllim të sigurimit të tokës për zbatimin e kompetencave të plota dhe ekskluzive të Komunës të parapara me nenin 17 LVL-së (Ligji nr.03/L-040), për planifikimin urban dhe rural; shfrytëzimin e tokës dhe zhvillimin, trajtimin e rrugëve locale, Kuvendi i Komunës së Gjiçanit, në mbledhjen e mbajtur me datë 26.03.2026 miraton këtë :

## V E N D I M

**Për lejimin e këmbimit të pronës së paluajtshme të komunës me pronën e paluajtshme të Nexhmedin Ibrahimit nga Përlepница.**

### I.

Kuvendi i Komunës e **APROVON** propozimin e Kryetarit të Komunës 02.nr.553 të dates 17.04.2025 për lejimin këmbimit të pronave të paluajtshme të komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Nexhmedin Ibrahimit nga Përlepница.

### II.

Sipas propozimit të cekur në pikën 1, këmbimi përfshinë :

- Pjesën prej 487 m<sup>2</sup> të njësisë kadastrale : P-70403054-01191-1, lloji i njësisë: parcelë; pronë private, zona rurale, vendi i quajtur "Glavina", sipërfaqja 1082 m<sup>2</sup>, kullosë e klasit 4, pronar : Nexhmedin Ibrahimit (Shefik) nga Përlepница.
- Pjesën prej 487 m<sup>2</sup> të njësisë kadastrale : P-70403054-01190-0, lloji i njësisë: parcelë; pronë shoqërore, zona rurale, vendi i quajtur "Glavina", sipërfaqja 2121 m<sup>2</sup>, rrugë e pakategorizuar, pronar : Komuna e Gjiçanit.

### III.

Pjesët e sipërfaqeve për këmbim gjinden në kufijt kadastral njëra me tjetrën, në Zonën Kadastrale në Përlepticë, kurse këmbimi i parcelave të përshkruara në pikën 2 të këtij propozimi bazohet në nevojën e rregullimit të një pjese të infrastrukturës rrugore publike dhe shfrytëzimit sa më efikas të sipërfaqeve bujqësore në këtë pjesë të fshatit Përlepticë.

### IV.

Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është Raporti i Vlerësimit financiar të pronave të cilat janë objekt i këmbimit, i datës 29.05.2025 i hartuar nga ana e Ministrisë së Financave dhe Transfereve, Departamenti për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme, Divizioni për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme për Shpronësim dhe Këmbim.

### V.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Gjilanit, Drejtorja për Urbanizem dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtorja për Gjeodezi, Kadaster dhe Pronë e KK-Gjilan, ndërsa për monitorim të zbatimit kujdeset Kryesuesi i Kuvendit Komunal Gjilan.

### VI.

Ky Vendim hynë në fuqi 30 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së dhe 7 dit pas publikimit në gjuhët zyrtare në uebfaqen e Komunës.

01.Nr.016-22112/26

Gjilan, më 26.03.2026



Kryesuesjs e KK Gjilan  
*[Signature]*  
/Krenare Latif Kqiku/